



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit- likuidimit të Ndërmarrjeve shoqërore nga AKP-ja

Trajnuesi:

Mr.sc Sahit Sylejmani, gjyqtar i Kolegjit të Apelit në DHPGJS

Prishtinë- 19.05.2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij moduli është e AD-së, ndërsa pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Hyrje

Në këtë prezantim lidhur me këtë temë do të jepet një vështrim lidhur me autorizimet ligjore të AKP-së në procesin e privatizimit dhe të likuidimit të NSH-vë, pataj për likuidimin si proces administrativ, trajtimin e kërkesave kreditore pranë Autoritetit të Likuidimit të NSH-ve, pastaj do të paraqitet një vështrim për aprovimin dhe refuzimin e kërkesave pranë AKP-së, si dhe procedurat e mëtejme të shqyrtimit të kërkesave pranë DHPGJS-së.

Prezantimi do të përfshinë procedurën administrative pranë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe procedurën gjyqësore pranë DHPGJS-së, të cilën kreditori i supozuar ndaj NSH-së është i obliguar të ndjek në bazë të ligjit të AKP-së dhe Shtojcës së tij dhe LDHP-së, për të realizuar kërkesën e paraqitur ndaj NSH-së në likuidim.

Qëllimi i këtij prezantimi por edhe i diskutimeve që do të bëhen lidhur me këtë temë, është ndërtimi i një metodologjie të avancuar të interpretimit dhe implementimit të dispozitave të ligjit të AKP-së dhe shtojcës së tij dhe LDHP-së, që e rregullojnë procedurën e likuidimit.

Objektivat trajnuese

Ky prezantim dhe diskutimet që priten të bëhen lidhur me këtë temë kanë për qëllim të arrihen objektivat e përcaktuara nga Akademia e Drejtësisë lidhur me këtë temë siç janë: njohja e procedurës së paraqitjes së një kërkesë në Autoritetin e Likuidimit për realizimin e kërkesave pronësore dhe kreditore, të kuptoj cilët persona mund të paraqitën procedurën që duhet ndjekur në Autoritetin e Likuidimit dhe në DHPGJS të kuptojnë kompetencat e Agjencisë lidhur me menagjimin e NSH-ve ,si dhe mënyra e transformimit që ka ndodhë tek disa ndërmarrje shoqërore, si dhe nëse ky transformim ka qenë diskriminues ose jo si dhe ecurin e procedurave që duhet të ndiqen gjatë procesit të privatizimit si dhe likuidimit të NSH-ve, por edhe ecurin e procedurave që duhet të ndiqen për ti ndjekur pretendimet pronësore dhe kreditore që i kanë kreditorët e mundshëm ndaj NSH-ve.

Pas përfundimit të këtij trajnimi synojmë që pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të kuptojnë rrjedhën e procedurave të privatizimit dhe likuidimit të NSH-ve, të vlerësojnë rastet kur transformimi i një NSH-je ka qenë apo nuk ka qenë diskriminues, të njohin kompetencat e Agjencisë lidhur me administrimin e NSH-ve, dhe i identifikimi se cilët persona kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e privatizimit dhe të likuidimit të NSH-ve.

Metodologjia trajnuese

Për realizimin e këtij trajnimi dhe për mes prezencës fizike të pjesëmarrësve të trajnimit në një sallë të Akademisë së Drejtësisë, synojmë që me diskutime interaktive të temës së shtruar ti shqyrtojmë të gjitha aspektet e temës së planifikuar për trajnim.

Mënyra më e përshtatshme dhe më efektive sigurishtë është diskutimi interaktivë në një tryezë tëë rumbullakët ku pas parashtrimit të temës nga moderatorët, do të hapej diskutim por edhe do u jipet mundësia të pranishmëve të parashtrorjën edhe pyetje të caktuara lidhur me këtë temë. Në këtë rast dhe në interes të shqyrtimit të detajuar të temës do të mund të trajtohen edhe shumë raste praktike nga jurisprudenca e Dhomës së Posaçme.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Fillimisht presim që të ketë pjesëmarrës të interesuar, që do të përfitojnë nga ky trajnimi. Ata do të kenë mundësi që të përfitojnë njohuri konkrete rreth procesit të privatizimit dhe likuidimit vullnetar të NSH-ve, gjegjësisht të aseteve të atyre NSH-ve, si dhe të njihen më për së afërmi me rastet praktike nga ky proces, duke filluar me procedurën administrative para AL-së e deri tek paditë/ankesat në Dhomën e Posaçme.

Burimet dhe literatura

Për përgatitjen e këtij trajnimi, janë përdorur disa burime ligjore por edhe vendime praktike si dhe rregullore të caktuara si:

Ligji i AKP-së, Ligji i DHPGJS-së, LMD, Ligji i Punës së Bashkuar, Ligji mbi Kapitalin shoqëror të ish RSFJ, Ligji mbi letrat me vlerë, Ligji për themelimin e Fondit për zhvillimin e ekonomisë së Serbisë, Ligji i Punës, Ligji i Procedurës Administrative, Rregullorja e AKP-së nr.1/22 e datës 28 shkurt 2022, për Regullat e Tenderit, Rregullorja e AKP-së për Politikën operative dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe vendimet e Dhomës së Posaçme që njihen si presedan për zgjidhjen e situatave të caktuara.

Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit-likuidimit të Ndërmarrjeve shoqërore nga AKP-ja

Si institucion kompetent dhe legjitim për privatizimin e pronës shoqërore në Kosovë pas hyrjes së Kosovës në protektoratin ndërkombëtar, ishte themeluar Agjencia Kosovare e Mirëbesimit(AKM) përmes Rregullores së UNMIK-ut 2002/12. Në bazë të kësaj rregulloreje të gjitha asetet e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike ishin futur nën menaxhimin dhe administrimin e AKM-së dhe ajo ushtronte funksionet dhe përgjegjësitë publike në mënyrë plotësisht të pa varur. Kjo agjenci kishte zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të lidhur kontrata, për të marrë, për të mbajtur apo për të shitur pronën, gjegjësisht asetet e ndërmarrjeve shoqërore dhe publike, kishte autorizim për shitjen, transferimin dhe likuidimin e aseteve të ndërmarrjeve të përkufizuara me këtë rregullore. AKM-ja në funksion të mbrojtjes së kësaj prone kishte kompetenca edhe për të paditur dhe për të qenë e paditur në gjykatë.

Pas nxjerrjes së Ligjit 03/L-067 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) nga Parlamenti i Kosovës dhe me Ligjin vijues të AKP-së të datës 31 gusht 2011 nr. 04/L-034, këto kompetenca të ish-AKM-së kishin kaluar tek AKP-ja. Ky ligj ishte nxjerrë bazuar në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e me qëllim të rivitalizimit të ekonomisë së Kosovës dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës.

AKP-ja, duke u bazuar në këto kompetenca ligjore e kushtetuese, kishte formuar edhe Bordin e Drejtorëve të AKP-së(Bordi) i cili kishte të drejtë që të nxjerr rregulla për procesin e ofertimit dhe të shitjes së këtyre aseteve të ndërmarrjeve shoqërore, neni 10.2.2. Konform nenit 15 paragrafi 2, pika 11, përcaktohen përgjegjësitë e Bordit për të miratuar krijimin e një ose më shumë korporatave, për t'i shitur, transferuar apo zgjidhur një pjesë apo të gjitha aksionet, si dhe të drejtën për të rifituar apo anuluar kontratën bazuar në nenin 8, paragrafi 2, 3 dhe 6 të këtij ligji. Ndërkaq, konform nenit 15, paragrafi 2, pika 12, të Ligjit të AKP-së, Bordi ka përgjegjësi për shitjen dhe transferimin e një pjese ose të gjitha aksioneve të një NSH-je, të krijuara sipas paragrafit 2.11 të këtij paragrafi një pale tjetër të jashtme.

Bazuar në këto kompetenca ligjore të AKP-së me datë 28 shkurt 2022 kishte miratuar Rregullorën e fundit nr.1/22 për Rregullat e Tenderit(më herët kanë qenë të miratuara edhe disa Rregullore tjera për Rregullat e Tenderit). Po ashtu më 22 dhjetor 2020, Bordi i AKP-së i kishte miratuar edhe Rregulloren nr. 4/2020 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore me të cilat janë rregulluar kushtet dhe mënyra e shitjes, transferimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, gjegjësisht aseteve të tyre.

Në këtë prezantim lidhur me këtë temë do të jepet një vështrim nga këndi procedural juridik i shqyrtimit të kërkesave pronësore dhe kreditore të cilat paraqiten ndaj NSH-së në likuidim bazuar në Rregulloret e cekura që zbatohen në AKP gjatë procesit të shitjes gjegjësishtë likuidimit të aseteve të NSH-së.

Prezantimi do të përfshinë procedurën administrative pranë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe procedurën gjyqësore pranë DHPGJS-së, të cilën kreditori i supozuar ndaj NSH-së është i obliguar t'i ndjek në bazë të ligjit të AKP-së dhe Shtojcës së tij dhe LDHP-së, për të realizuar kërkesën e paraqitur ndaj NSH-së në likuidim. I ftojme dhe i inkurajojmë pjesëmarrësit e këtij sesi trajnues, që të paraqesin vështirësitë dhe dilemat që i kanë me rastin e interpretimit dhe zbatimit të këtyre dispozitave ligjore.

I. Vështrime të përgjithshme të procedurës së privatizimit të nsh-ve

Procedura e privatizimit të NSH-ve është njëri nga proceset ligjore e përcaktuar me Ligjin e AKP-së, dhe me Rregulloren nr 1/22 për Rregullat e Tenderit të aprovuar nga AKP-ja, përmes të cilave bëhet shitja e aseteve të NSH-së në procedurën e privatizimit e përcaktuar me Ligjin e AKP-së dhe Shtojcën e tij, dhe me Rregullat e Tenderit. Procedura e privatizimit të NSH-së që zhvillohet nga AKP-ja ka disa faza përmes të cilave realizohet shitja e aseteve të NSH-ve. Në këtë prezentim do të paraqiten vetëm veprimet apo hapat më të rëndësishme që duhet të ndërmerren nga AKP-ja dhe nga personat fizik ose juridik që pretendojnë ti blejnë asetet e NSH-ve, të cilat janë të rregulluara me Ligjin e AKP-së dhe me Rregullat e përgjithshme të tenderit.

Aspektet teknike dhe administrative të rregulluara me Rregullat e Tenderit, që gjithashtu duhet të respektohen nga pjesëmarrësit në tenderë, për shkak të kohës, edhe pse janë përcaktuar në procedurën e tenderimit që zhvillohet në AKP, nuk do të trajtohen në këtë prezentim.

1. Veprimet kryesore në procedurën e tenderimit të aseteve të NSH-ve

Bordi i AKP-së, në mbështetje të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit të AKP-së, dhe në mbështetje të Politikave Operative të Agjencisë, e ka miratuar Rregulloren e fundit nr. 1/2022 Për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit.

Me këto rregulla të tenderit janë përcaktuar procedurat për privatizimin e “subjekteve të reja” dhe për shitjen e “asetit të tenderuar” përmes likuidimit, siç janë definuar me këto rregulla të tenderit, duke përfshirë kushtet dhe kriteret për paraqitjen e ofertave nga ana e ofertuesve, kushtet dhe kriteret për klasifikimin dhe përzgjedhjen e ofertave nga ana e Agjencisë si dhe kushtet e kriteret për lidhjen e kontratave të shitjes me ofertuesit fitues të përkohshëm.

2. Vlefshmëria juridike dhe interpretimi i Rregullave të Tenderit

Rregullat e Tenderit janë të detyrueshme për zbatim si për Agjencinë ashtu edhe për çdo person i cili merr pjesë apo përfshihet në procedurat e privatizimit apo likuidimit. Për t’u marrë parasysh një ofertë, duhet të jetë në pajtim me Rregullat e Tenderit. Me pjesëmarrjen e ofertuesit në çfarëdo faze të tenderimit ose me dorëzimin e ofertës, ofertuesi pajtohet me rregulla dhe ndërmerr masa që t’iu nënshtrohet kushteve dhe procedurës së përcaktuar me Rregullat e Tenderit.

3. Aspekte të përgjithshme mbi procesin e shitjes dhe roli i AKP-së në këtë procesë

Agjencia Kosovare e Privatizimit, është institucion i pavarur publik i Republikës së Kosovës, e cila ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj me autonomi të plotë, në përputhje me Ligjin për Agjencinë, me Politikën Operacionale të Agjencisë, dhe me këto Rregulla të Tenderit dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore që janë në fuqi në Republikën e Kosovës.

Agjencia në bazë të Ligjit të AKP-së ka në mandatin e saj që të administroj me ndërmarrjet dhe asetet siç është përcaktuar me Ligjin për Agjencinë, duke përfshirë edhe autoritetin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e tyre. Agjencia ka zotësi të plotë juridike dhe rrjedhimisht mund të jetë palë paditëse apo e paditur, në procedurën gjyqësore apo në ndonjë procedurë të ngjashme.

4. Struktura e shitjes dhe pasqyra e ofertës

Agjencia në emër të NSH-së do të themelojë subjektin e ri dhe Agjencia do të mbaj në mirëbesim për NSH-në, kapitalin e subjektit të ri, të nxjerrë në aksione. Si pjesë integrale e tenderit, Agjencia do të kryej shitjen e kapitalit të subjektit të ri të nxjerrë në aksione, në emër të NSH-së, dhe artikujt e tenderuar do të transferohen tek subjekti i ri për një kohë të caktuar. Subjekti i ri dhe asetit i tenderuar do të tenderohet për shitje në tender publik në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulla e Tenderit. Gjatë tenderit do të jetë një raund i ofertimit dhe këto rregulla të tenderit përcaktojnë procedurat që qeverisin tenderin, informatat dhe dokumentet që duhet të përfshihen në ofertë, identifikimin e çmimit të ofertës më të lartë dhe mënyrën se si të vazhdohet shitja e subjektit të ri dhe asetit të tenderuar, ofertuesit fitues të përkohshëm.

Për t'u marrë parasysh një ofertë, ofertuesi duhet të jetë në pajtim me Rregullat e Tenderit. Me pjesëmarrjen e ofertuesit në çfarëdo faze të tenderit ose me dorëzimin e ofertës, ofertuesi pajtohet dhe ndërmerr masa që t'i nënshtrohet kushteve të këtyre rregullave për tender. Sipas nenit 4.2.3. me dorëzimin e ofertës, ofertuesi duhet të përcaktoj se për cilin subjekt të ri apo aset të tenderuar është duke konkurruar dhe duhet të jap çmimin e ofertës.

5. Shitja bëhet sipas ofertës me çmimin më të lartë

Agjencia do të shes subjektin e ri apo asetin e tenderuar vetëm me çmimin e ofertës më të lartë. Ofertuesi më i lartë do të ketë të drejtë që të blejë asetin e tenderuar, vetëm me çmimin e ofertës më të lartë. Nëse për çfarëdo arsye, shitja nuk vazhdohet me ofertuesin më të lartë atëherë ofertuesi i dytë më i lartë duke iu nënshtrohet këtyre rregullave të tenderit do të ketë mundësinë, por nuk është i detyruar, të blejë subjektin e ri apo asetin e tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë. Nëse për çfarëdo arsye, shitja nuk vazhdohet me ofertuesin e dytë më të lartë atëherë ofertuesi i tretë më i lartë duke iu nënshtrohet këtyre rregullave të tenderit do të ketë mundësinë, por nuk është i detyruar, të blejë subjektin e ri apo asetin e tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë.

6. Orari i tenderit

Agjencia do të përgatis orarin e tenderit (i cili është i bashkëngjitur në Rregullat e Tenderit, si Shtojca A). Ofertuesit duhet të konsultojnë orarin e tenderit, të informohen lidhur me afatet dhe datat e përcaktuara me të dhe t'u përmbahen atyre gjatë procesit të tenderimit.

7. Ofertuesit me ndalesë ofertimi

Sipas nenit 5.1 të Rregullave të tenderit ofertuesit në vijim do të kenë ndalesë ofertimi:

- 1.1. Ndërmarrjet publike dhe shoqërore;
- 1.2. Qeveria dhe institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës, agjencitë dhe institucionet publike të pavarura;
- 1.3. Qeveria, institucionet qeveritare, agjencitë dhe institucionet e tjera publike të cilitdo shtet apo vend tjetër;

1.4. Personat fizik, personat juridik apo shoqëritë tregtare si dhe personat kontrollues dhe udhëheqës të personave juridik apo shoqërive tregtare të cilët janë të dënuar me burgim në kohëzgjatje një vit e më tepër për vepra penale kundër ekonomisë, rendit kushtetues, vepra që lidhen me krim të organizuar dhe të gjitha ato vepra penale që ngërthejnë në vete elemente të mashtrimit, të parapara me Kodin Penal,

7

1.5. Personat fizik apo juridik të cilët kanë uzurpuar paluajtshmërinë në pronësi shoqërore ndaj të cilëve. Agjencia apo NSH-ja ka iniciuar procedurë gjyqësore për lirimin e pronës dhe/apo kompensimin e dëmeve eventuale, me përjashtim të palëve që kanë nënshkruar kontratë të qirasë me Agjencinë apo palëve që nuk kanë kontratë të qirasë, por që këto palë e kanë paguar kompensimin e të gjitha detyrimeve për shfrytëzimin e pronës së NSH-së;

1.6. Personat fizik dhe juridik që: (i) nuk i kanë respektuar kushtet e ndonjë kontrate të lidhur me Agjencinë ose me çfarëdo ndërmarrje që administrohet nga Agjencia (ekzistenca dhe natyra e atij mosrespektimi do të përcaktohet nga Agjencia sipas zgjedhjes së saj), (ii) kanë borxh ose gjobë të pashlyer ndaj Agjencisë ose ndonjë ndërmarrje që administrohet nga Agjencia, (iii) të cilët nuk kanë paguar gjobat e caktuara nga Agjencia ose që i nënshtrohen ndonjë kërkesë padie ose kontesti (pa marrë parasysh nëse çështja e tillë është ngritur në gjykatë apo tjetërkund).

Përjashtimisht, palët të cilat e paguajnë borxhin ndaj Agjencisë ose NSH-ve para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nuk konsiderohen ofertues me ndalesë; 1.6.1. Personat fizik dhe juridik të cilët sipas mendimit të arsyeshëm dhe të argumentuar të Agjencisë: janë përfshirë në ndonjë marrëveshje të fshehtë apo në ndonjë aktivitet tjetër jo ligjor apo të pa rregullt, dhe si rrjedhojë Agjencia ka anuluar ndonjë tender të likuidimit; 1.6.2. në ndonjë mënyrë tjetër kanë shkelur rregullat e tenderit për çfarëdo tenderi të privatizimit apo likuidimit, të organizuar nga Agjencia; ose 1.6.3. janë tërhequr nga pozita e tyre si ofertues fitues i përkohshëm në ndonjë tender të likuidimit dy (2) herë pas dështimit për të depozituar shumën e çmimit të ofertës së tyre fituese brenda periudhës së kërkuar nga Agjencia ose përmes refuzimit të tyre për të nënshkruar dokumentet e shitjes gjatë çfarëdo tenderi të privatizimit të organizuar nga Agjencia;

1.7. Subjektet juridike, ku pronarët përfitues ose personat kontrollues të tyre i takojnë kategorive të theksuara në këtë nen; 1.8. Subjektet juridike ku pronarët, personat përfitues apo personat kontrollues të tyre kanë qenë apo janë pronarë, persona përfitues apo persona kontrollues të ndonjë subjekti tjetër juridik, i cili i takon ndonjërit nga kategoritë e theksuara në këtë nen.

Sipas nenit 5.2 të Rregullave të tenderit çfarëdo oferte e dorëzuar nga një ofertues me ndalesë ofertimi do të mund të diskualifikohet, pavarësisht nga fakti nëse oferta e tillë është në pajtim të plotë me kushtet dhe afatet e përcaktuara me Rregullat e Tenderit.

8. Hulumtimi paraprak dhe marrja e dokumenteve të tenderit

Sipas nenit 6.1 të Rregullave të tenderit është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në, subjektin e ri apo asetin e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Sipas nenit 6.2. në njoftimin për tender, ofertuesit e mundshëm udhëzohen që brenda afatit të caktuar të kontaktojnë zyrën e caktuar në Agjenci për marrjen e dokumenteve përkatëse të tenderit, përfshirë dosjen elektronike.

Duke vepruar sipas kërkesave të ofertuesve të mundshëm, Agjencia para dorëzimit të ofertave, do t'iu mundësoj atyre që të vizitojnë vendndodhjen dhe hapësirat e NSH-së, asetit të tenderuar sipas publikimit në shpalljet e tenderit. Ofertuesit e mundshëm duhet të paraqesin kërkesat e tyre dhe të caktojnë takimet apo vizitat vetëm përmes Agjencisë.

Moskryerja e hulumtimeve paraprake dhe vlerësimeve të pavarura në lidhje me NSH-në, subjektin e ri apo asetin e tenderuar, si dhe në lidhje me çfarëdo dhe të gjitha informatat dhe dokumentet që gjenden në dosjen elektronike, nuk e liron ofertuesin e mundshëm nga kryerja e obligimeve të tij sipas kontratës së shitjes dhe dokumenteve të tjera përkatëse.

Në bazë të këtyre rregullave as Agjencia e as NSH-ja nuk marrin përgjegjësi ose obligim në lidhje me çfarëdo mungese në informatat dhe dokumentet që janë në dispozicion në lidhje me NSH-në, subjektin e ri apo asetin e tenderuar.

9. Tarifa për dorëzimin e ofertës dhe depozita e ofertës

Sipas nenit 7.1. për kompensimin e kostove administrative dhe të komunikimit të cilat janë të lidhura me shqyrtimin dhe përpunimin e ofertave nga ana e Agjencisë, secili ofertues duhet të paguaj tarifën për dorëzimin e ofertës, në shumën prej 200 € (dyqind euro). Ofertuesi së bashku me ofertën e tij duhet të dorëzoj edhe dëshminë e pagesës së tarifës. Sipas nenit 7.2 secili ofertues duhet që të paguaj depozitën e ofertës, lartësia e së cilës caktohet nga Agjencia, në baza individuale për secilin subjekt të ri apo aset të tenderuar. Ofertuesve jo fitues Agjencia do t'ua kthej depozitën e ofertës brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertës.

10.Përmbajtja dhe dorëzimi i ofertave

Sipas nenit 8.1. Gjatë tenderit do të ekzistoj vetëm një raund i ofertimit. Të drejtën për të paraqitur ofertë e gëzon çdo person fizik apo juridik. Për një aset mund të dorëzohet vetëm një ofertë nga i njëjti ofertues. Personi i cili dorëzon ofertën nuk duhet të identifikoj ofertuesin në emër të të cilit dorëzon ofertën. Ofertat duhet të dorëzohen në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës (gjuhë shqipe apo serbe), ose në gjuhën angleze.

Sipas nenit 8.4. ofertat duhet të dorëzohen të mbyllura në vendin e caktuar nga Agjencia përmes njoftimit për tender. Ofertat duhet të dorëzohen në mënyrë fizike pranë komisionit të Agjencisë për pranimin e ofertave. Sipas nenit 8.6. ofertat duhet t'i dorëzohen komisionit për pranimin e ofertave gjatë periudhës për dorëzimin e ofertave në pajtim me këtë rregullore.

Komisioni për pranimin e ofertave nuk do të pranoj ofertat të cilat paraqiten pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertave ose që paraqiten në ndonjë vend tjetër përveç siç është përcaktuar në nenin 8.5 të kësaj rregulloreje. Ofertës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë dhe dokumentet e kërkuara në tenderë.

Në momentin e dorëzimit të ofertës, secilit ofertues i përcaktohet një shifër identifikuese. Sipas nenit 8.11. gjatë ditës së shitjes apo ceremonisë së hapjes së ofertave, Komisioni Verifikues do të shqyrtojë vetëm ofertat të cilat kanë hasur në parregullsi apo probleme nga tavolina kontrolluese, para se ato të dërgohen tek Komisioni për hapjen e ofertave.

11. Shpallja e fituesit të përkohshëm dhe pagesa e çmimit të blerjes.

Sipas nenit 9.1 të Rregullave të tenderit ofertat do të hapen nga komisioni për hapjen e ofertave, në mënyrë publike, menjëherë pas përfundimit të periudhës për dorëzimin e ofertës. Procesi i hapjes së ofertave vazhdon derisa të hapet oferta e fundit. Sipas nenit 9.2. Komisioni për hapjen e ofertave do të bëjë identifikimin dhe shpalljen publike të çmimeve të të gjitha ofertave të dorëzuara për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar. Komisioni i regjistrimit të ofertave do të bëjë inkorporimin e ofertave të pranuar në ditën e shitjes apo ceremoninë e hapjes së ofertave, në formë tabelare, publikisht.

12. Procedurat e verifikimit

Sipas nenit 10.1 të Rregullave të tenderit Agjencia në çdo kohë duke përfshirë edhe fazën e përmbylljes së kontratës së shitjes së subjektit të ri apo asetit të tenderuar, mund të kërkojë nga ofertuesi dorëzimin e informatave apo dëshmime shtesë në pajtim me këtë rregullore, të cilat i vlerëson si relevante për statusin e ofertuesit me çmimin më të lartë. Nëse brenda një vale të shitjes, një ofertues ka aplikuar për më shumë se një aset dhe i njëjti është shpallur ofertues me çmimin më të lartë për më shumë se një aset, konstatimi si ofertues me ndalesë vlen për të gjitha rastet. Komisioni vlerësues do të konstatojë se ofertuesi me çmimin më të lartë bie në kategorinë e ofertuesve me ndalesë (siç janë përcaktuar me nenin 5 të kësaj rregullore) edhe në rastin kur ofertuesi nuk ka dorëzuar dëshmitë gjegjëse edhe përkundër kërkesës nga ana e personelit të Agjencisë për kompletimin e lëndës.

13. Shpallja e fituesit të përkohshëm dhe pagesa e çmimit të blerjes

Sipas nenit 11.1 të Rregullave të tenderit duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, aseti i tenderuar i shitet ofertuesit më të lartë sipas kushteve në vijim:

Sipas nenit 1.1. Agjencia brenda 3 (tre) ditë pune nga periudha për dorëzimin e ofertës njofton ofertuesin me çmimin më të lartë të ofruar, se oferta e tij është ranguar si më e larta.

Sipas nenit 1.2. Ofertuesi me çmimin më të lartë (personat fizik, përfaqësuesit apo pronarët e personave juridik, apo konsorciumet) duhet të dorëzojnë dokumentet e specifikuar të cilat janë përcaktuar me Rregullat e tenderit, brenda afatit të cekur në njoftimin e Agjencisë.

Sipas nenit 11.2 të Rregullave të tenderit, njoftimi për vendimin mbi shpalljen e fituesit të përkohshëm apo anulimin e shitjes kumtohet pasi që Bordi të miratojë apo refuzoj shitjen dhe se depozita nuk kthehet deri në marrjen e këtij vendimi.

Në bazë të nenit 11.3. pas aprovimit të çmimit të shitjes nga Bordi i drejtorëve, Agjencia do të ftoj ofertuesin të paguaj çmimin e ofertës më të lartë, në xhirlogarinë e caktuar, sipas afateve të përcaktuara nga agjencia, dhe se kohëzgjatja e afateve mëvaret nga lartësia e ofertës së dhënë. Ky afat mund të jetë prej 45 deri 60 ditë.

Sipas nenit 11.4. të Rregullave të tenderit fituesit të përkohshëm do t'i merret e drejta për kryerjen e blerjes së subjektit të ri apo asetit të tenderuar dhe do t'i konfiskohet depozita e ofertës nga Agjencia për shkak se ka dështuar ta bëjë pagesën në afatin e dhënë.

14. Diskualifikimi i ofertuesit i shpallur si fitues i përkohshëm

Sipas nenit 11.7 të Rregullave të tenderit në rast se Agjencia e diskualifikon ofertuesin fitues të përkohshëm (siç është përcaktuar në Rregulla të Tenderit), Agjencia do të kontaktoj ofertuesin e dytë më të lartë duke e ftuar që të blej asetit e tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë të ofertuesit të parë. Ofertuesi i dytë më i lartë brenda afatit prej tre (3) ditë pune pas pranimit të shkresës nga Agjencia e njofton Agjencinë me shkrim nëse dëshiron të vazhdojë me blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë; dhe e transferon depozitën e ofertës në xhironlogarinë bankare të caktuar nga Agjencia për atë qëllim, në rast se depozita e ofertës i është kthyer ofertuesit të dytë më të lartë në pajtim me këtë rregullore.

Nëse ofertuesi i dytë më i lartë nuk vepron sipas paragrafit 8.1 dhe 8.2 të këtij neni, atëherë Agjencia do të ketë të drejtën që mos përgjigjen e tij ta trajtojë si refuzim të ftesës së Agjencisë për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar. Nëse ofertuesi i dytë më i lartë nuk dëshiron të bëjë blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë atëherë Agjencia do të vazhdojë procesin duke e ftuar ofertuesin e tretë më të lartë që të blejë subjektin e ri apo asetit të tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë.

Rregullat e Tenderit të cilat zbatohen për ofertuesin më të lartë do të zbatohen edhe për ofertuesin e dytë më të lartë, dhe po ashtu Rregullat e Tenderit të cilat zbatohen për ofertuesin e parë dhe të dytë më të lartë, do të zbatohen në mënyrë identike edhe kur kemi të bëjmë me ofertuesin e tretë më të lartë. Nëse shitja e asetit të tenderuar dështon atëherë Agjencia do të anulojë tenderin.

15. Klasifikimi i ofertave me çmime të njëjta

Në bazë të nenit 12 të rregullave të tenderit, në rast se ekzistojnë dy ose më shumë oferta të dorëzuara nga ofertuesit të cilët kanë çmime të njëjta, atëherë prioritet do të ketë oferta e cila është dorëzuar dhe regjistruar më herët për nga koha.

16. Modifikimi dhe tërheqja e ofertave

Sipas nenit 13.1 të Rregullave të tenderit nuk lejohet asnjë ndryshim/përmirësim i çmimit të ofertës, ndërsa Agjencia do të shpallë të pavlefshme ofertën e dorëzuar e cila ka ndryshim/përmirësim të çmimit të ofertës së dorëzuar. Pas dorëzimit të ofertës në vendin e caktuar sipas shpalljes në tenderin publik, ofertuesi nuk mund të tërheqë ofertën e tij. Në rast se ofertuesi e tërheqë ofertën e tij pas dorëzimit të saj, do t'i konfiskohet depozita e ofertës, përveç rasteve kur ofertuesi e tërheqë ofertën mbi bazën e nenit 11.5 të kësaj rregulloreje.

17. Aprovimi dhe refuzimi i ofertave nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së

Në bazë të nenit 14.1, të Rregullave të tenderit, Bordi i Drejtorëve aprovon shitjet, bazuar në informatat relevante të prezantuara sipas metodologjisë për përcaktimin e çmimeve orientuese, nëse çmimi i ofertës më të lartë të artikujve të tenderuar ka lidhje racionale me vlerën orientuese sipas Shtojcës së Procedurave të Shitjes, rrjedhimisht ekzistojnë arsyet ekonomike që të aprovohet oferta.

Në bazë të nenit 14.2, të këtyre rregullave, Bordi i Drejtorëve i refuzon ofertat e pranuar në rastet si në vijim:

2.1. Nëse sipas vlerësimit të Bordit, bazuar në informatat relevante të prezantuara sipas metodologjisë për përcaktimin e çmimeve orientuese, çmimi i ofertës më të lartë për asetit e tenderuar nuk ka lidhje racionale me vlerën orientuese sipas Shtojcës së Procedurave të Shitjes;

2.2. Nëse Agjencia pranon indikacione të bazuara apo dyshime të bazuara për ndonjë marrëveshje të fshehtë në mes të ofertuesve, apo në ndonjë aktivitet tjetër ilegal apo të parregullt të shkaktuar në lidhje me procesin e tenderimit.

2.3. Në rastet e refuzimit të ofertave, depozitat kthehen sipas procedurave të parapara me këtë rregullore.

Sipas nenit 14.5. në rastet kur tenderi anulohet, për arsye të cilat e bëjnë të pamundur aprovimin apo refuzimin e ofertës sipas nenit 14.1 dhe 14.2 të kësaj rregullore, Agjencia njofton me shkrim ofertuesin me çmimin më të lartë për anulimin e tillë. Në këtë rast:

5.1 të gjitha depozitat e ofertave të pranuar dhe tarifat administrative do të kthehen nga Agjencia brenda afatit prej 10 ditë pune nga dita e anulimit të tenderit.

5.2 përjashtimisht tarifa administrative do të kthehet edhe në raste tjera përveç më lartë me vendim të Bordit, nëse anulimi i tenderit është bërë pa fajin e ofertuesve.

18. Kontrata e shitjes

Në bazë të nenit 15.1 të Rregullave të tenderit Agjencia dhe ofertuesi fitues i përkohshëm do të bëjnë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të nënshkruar kontratën e shitjes brenda afatit prej 20 (njëzetë) ditë pune nga data e pagesës së plotë të çmimit të shitjes.

Agjencia sipas zgjedhjes së saj duke njoftuar ofertuesin fitues të përkohshëm mund ta zgjasë afatin e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni, në rast se beson që ka nevojë të arsyeshme shtesë për të shqyrtuar ndonjë aspekt të kontratës së shitjes ose për shkak të disa rrethanave tjera që rezultojnë me shtyrje. Ky afat mund të shtyhet më së shumti edhe pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.

Në bazë të nenit 15.5. të Rregullave të tenderit,

Në rast se diskutimet ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesit fitues të përkohshëm në lidhje me kontratën e shitjes nuk janë të suksesshme (sipas mendimit të arsyeshëm të Agjencisë) brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni apo pas çfarëdo vazhdimi të afatit të tillë, atëherë Agjencia do të ketë të drejtë që të përcaktojë pamundësinë e realizimit të shitjes së subjektit të ri apo asetit të tenderuar me ofertuesin fitues të përkohshëm.

Në bazë të nenit 15.7 të Rregulloreve të tenderit, Kontrata e shitjes dhe dokumentet e tjera që ndërliken me të do të nënshkruhen nga palët vetëm pas pagesës së shumës së përgjithshme të çmimit të ofertës më të lartë dhe përfundimit të pagesave dhe detyrimeve të tjera eventuale që ndërliken me procesin e tenderimit.

19. Refuzimi i ofertuesit i shpallur si ofertues fitues

Në bazë të nenit 16.3 të Rregullave të tenderit, është paraparë që nëse Agjencia vërteton që informatat e dhëna në ofertën e ofertuesit fitues të përkohshëm janë të pasakta, mund të refuzojë një ofertë të ofertuesit fitues të përkohshëm dhe do të ndërpresë procedurën e tenderimit në relacion me të.

Ofertuesit fitues të përkohshëm do t'i konfiskohet edhe depozita e ofertës. Në rastet e tilla, Agjencia mund të kontakton ofertuesin e radhës dhe ta ftoj atë që të deklarohej nëse dëshiron të realizojë blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar me çmimin e ofertës më të lartë. Në rastet e tilla do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme, dispozitat e Rregullave të Tenderit, e të cilat kanë të bëjnë me ofertuesin e dytë më të lartë dhe ofertuesin e tretë më të lartë.

20. Marrëdhënia kontraktuese nuk krijohet vetëm për shkakë të pjesëmarrjes në tenderë

Qëllimi i Rregullave të Tenderit nuk është domosdo krijimi ndonjë marrëveshje kontraktuese ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesve, megjithëse shpallja e tenderit bëhet që të arrihet ky qëllim. Rrjedhimisht, nuk do të konsiderohet se ekziston ndonjë kontratë ndërmjet Agjencisë dhe një ofertuesi vetëm për shkak të pjesëmarrjes së ofertuesit të tillë në çfarëdo aspekti të tenderit. Nuk do të ketë asnjë raport juridikdetyrimor ndërmjet Agjencisë dhe ofertuesit fitues të përkohshëm deri në hyrjen në fuqi të kontratës së shitjes.

Në bazë të nenit 16.3.2, të Rregullave të tenderit, Kontrata e shitjes e subjektit të ri apo asetit të tenderuar konsiderohet se hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit të dyanshëm të saj nga ana e Agjencisë dhe nga ana e blerësit apo përfaqësuesit të autorizuar të tij me autorizim të noteri. Prej momentit të nënshkrimit të kontratës së shitjes, nga të dy palët e cekura më sipër, ofertuesi do të konsiderohet blerës i subjektit të ri apo asetit të tenderuar.

21. Mundësitë e anulimit të kontratës së shitjes

Rregullat e tenderit në nenin 16.5 përcaktojnë mundësinë që Agjencia edhe mund të anuloj kontratën e nënshkruar të shitjes në çfarëdo periudhe, në rastet e përcaktuara në nënparagrafet vijuese:

5.1. Nëse konstatohet nga organet kompetente se mjetet e përdorura nga ofertuesi fitues i përkohshëm për blerjen e subjektit të ri apo asetit të tenderuar rrjedhin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga aktiviteti i kundërligjshëm;

5.2. Nëse konstatohet se gjatë procesit të tenderimit blerësi ka qenë i përfshirë në marrëveshje të fshehtë; ose

5.3. Nëse konstatohet se ka shmangie apo shkelje të dispozitave themelore të Rregullave të Tenderit.

II. Vështrime të përgjithshme të procedurës së likuidimit

Likuidimi është proces ligjor përmes të cilit bëhet shitja e aseteve të NSH-së në procedurën e përcaktuar me ligjin e AKP-së dhe Shtojcën e tij. Procedura e likuidimit të NSH-së ka disa faza përmes të cilave realizohet shitja e aseteve të NSH-së në likuidim.

Qëllimi i këtij prezantimi do të jetë shqyrtimi i procedurës administrative dhe gjyqësore, përmes së cilave trajtohen kërkesat kreditore dhe pronësore ndaj NSH-së në likuidim.

Fillimisht duhet theksuar se për të filluar procedura e likuidimit të NSH-së, duhet një vendim i Bordit të AKP-së. Në bazë të nenit 9 të Ligjit të AKP-së dhe nenit 4 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve i AKP-së ka autoritetin ligjor të fillojë procedurën e likuidimit ndaj një NSH-je, kur vlerëson se “procedura e tillë është në interes të kreditorëve ose pronarëve përkatës”. Fillimi i procedurës së likuidimit ndaj një NSH-je, krijon gjendjen e re juridike në NSH.

Sipas nenit 5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, fillimisht menaxhmenti i AKP-së e përgatit një propozim për Bordin për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së. Forma dhe përmbajtja e këtij propozimi përkufizohet me politikën operationale të nxjerra nga Bordi i AKP-së, në pajtim me nenin 10 të Ligjit të AKP-së. Pas vendimit për likuidim të NSH-së, Bordi emëron Autoritetin e Likuidimit në pajtim me procedurën e përshkruar në nenin 12 të kësaj Shtojce.

Në bazë të nenit 8 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së në mesnatën e datës kur është marrë vendimi mbi likuidimin e NSH-së, prishen të gjitha kontratat e punës të punëtorëve të NSH-së, nëse ka pasur kontrata të tilla. Ndërsa në bazë të nenit 9 të shtojcës së Ligjit të AKP-së ndërprehen edhe të drejtat menaxheriale të menaxhmentit të deritanishëm të NSH-së që hynë në likuidim, dhe këto të drejta barten tek Autoriteti i Likuidimit.

AKP-ja pas vendimit të Bordit që të fillojë procedurën e likuidimit ndaj një NSH-je bazuar në neni 7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, brenda 10 ditëve të punës publikon apo kërkon nga Autoriteti i Likuidimit të publikoj Njoftimin për likuidim. Publikimi i këtij njoftimi bëhet në pajtim me dispozitat për shpallje të kësaj Shtojce.

Neni 7.2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, ka përcaktuar elementet që duhet ti përmbajë njoftimi për likuidim. Këto elemente të këtij njoftimi kanë të bëjnë me procedurat, kërkesën, dokumentet dhe formularët e ndryshëm që duhet përgatitur për të parashtruar kërkesën ndaj NSH-së në likuidim. Në njoftim gjithashtu duhet të ceket afati i parashtrimit të kërkesës, dhe ku duhet drejtuar kërkesa si dhe elemente tjera të hollësishme për të paraqitur kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit. Autoriteti i Likuidimit në bazë të nenit 7.3 në këtë njoftim mund të përfshijë edhe elemente tjera jashtë atyre të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.

Sipas nenit 7.4 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së Autoriteti i Likuidimit brenda 10 dite pune pas datës së publikimit të parë të njoftimit për likuidim i dërgon me postë një kopje të njoftimit për likuidim çdo personi që më herët ka informuar me shkrim Agjencinë apo gjykatën lidhur me kërkesën apo interesin e pretenduar ndaj ndërmarrjes apo aseteve të ndërmarrjes. Sipas nenit 7.5 të shtojcës publikimi i njoftimit për likuidim do të përsëritet pas 15 ditëve pas publikimit fillestar të njoftimit për likuidim. Me këtë rast afati për parashtrimin e kërkesave mbetet ai që është saktësuar në njoftimin fillestar.

1.Rregullorja nr.4/2020 për politikat dhe procedurat e likuidimit të Ndërmarrjeve shoqërore

Siç u tha edhe më lartë, në mbështetje të nenit 9 dhe 15 paragrafi 2.1 të Ligjit mbi AKP-në dhe në mbështetje të Shtojcës së këtij Ligji, Bordi i AKP-së më 22 dhjetor 2020, kishte miratuqar Rregulloren nr.4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Me këtë rregullore rregullohet puna e Autoritetit të Likuidimit(AL) lidhur me kërkesat e kreditorëve, kushtet për parashtrimin dhe për njohjen e kërkesave të kreditorëve si dhe e gjithë proceduar administrative e paraparë deri në nxjerrjen e vendimit nga AL lidhur me kërkesën e parashtruar.

2. Formulari i kërkesës kreditore

Neni 9 i kësaj rregullore qartëson se, AKP-ja posedon me formular standard të kërkesave kreditore, atë të Dëshmisë së Kërkesës dhe Dëshmisë së Interesit. Formularët e kërkesës janë dizajnuar për t’iu mundësuar parashtruesve të kërkesës kreditore të ofrojnë informatat e domosdoshme/obligative siç parashihet në nenin 23.1 të Shtojcës së Ligjit. Të gjitha kërkesat kreditore mund të parashtrohen vetëm në formularin standard të AKP-së.

Për kërkesat që nuk e kanë arritur afatin e pagesës, për qëllime të dorëzimit të Dëshmisë së Kërkesës, do të konsiderohet se ato e kanë arritur afatin e pagesës që nga data e Vendimit për Likuidim në pajtim me nenin 23.4 të Shtojcës së Ligjit.

3. Regjistrimi i kërkesave kreditore

Konform nenit 9.2 të kësaj rregulloreje, brenda dhjetë (10) ditësh pas publikimit të parë të Njoftimit për Likuidim, AL-ja duhet t’i njoftoj të gjithë kreditorët e njohur të NSH-së me shkrim për fillimin e likuidimit se ata duhet të paraqesin Dëshmitë e Kërkesës apo Dëshmitë e Interesit në përputhje me Njoftimin për Likuidim.

Është parim i përgjithshëm i të gjitha sistemeve ligjore, që personi që parashtron një kërkesë kreditore në likuidim, atëherë ai e bartë barrën e dëshmisë për të. Në mungesë të kërkesave specifike ligjore për forma të veçanta të dëshmisë, kreditori mund të dëshmoj kërkesën me çdo mënyrë që është e besueshme apo relevante.

Kërkesat e kreditorëve dhe bartësve të supozuar të interesit duhet të regjistrohen nga Autoriteti i Likuidimit brenda katërdhjetë e pesë (45) ditësh që nga data e publikimit të “Njoftimit për Likuidim”.

Të gjitha kërkesat e pranuar nga Autoriteti i Likuidimit do të jenë të vulosura me datën dhe kohën e dorëzimit në AKP.

Autoriteti i Likuidimit në pajtim me Nenin 23.6 të Shtojcës 1 të Ligjit, do të mbaj një regjistër të kërkesave dhe dëshmive të interesit. Kërkesat e pranuar nga Autoriteti i Likuidimit do të futen në regjistrin e lart-përmendur dhe prej aty e tutje do të njihen si “Parashtrues të regjistruar të kërkesave”. Afatet kohore për t’u marrë me kërkesa janë të specifikuar në Nenin 37.4 i Shtojcës së Ligjit i cili thotë: “Menjëherë pas Afatit për parashtrimin e kërkesave,

Autoriteti i Likuidimit vlerëson vlefshmërinë, shtrirjen dhe prioritetin e kërkesave dhe pengjeve apo kolateraleve të ndërlidhura të paraqitura ndaj Ndërmarrjes dhe njofton kërkuarët në fjalë lidhur me rezultatet e atij vlerësimi”.

Fjala “menjëherë” interpretohet si “brenda 60 ditësh” apo periudhë e tillë kohore sipas zgjedhjes së Agjencisë.

Kur të parashtrohet kërkesa, AL-ja duhet të merr parasysh se çfarë dokumente apo të dhënash duhet të ekzistojnë në mënyrë që të vërtetohet kërkesa. Nëse pretenduesi nuk i ka siguruar këto dokumente, atëherë sipas nenit 23.3 dhe 37.5 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, Autoriteti i Likuidimit mund të kërkojë informata dhe dëshmi shtesë nëse i konsideron si të nevojshme për ta kryer vlerësimin. Kërkesa për informata shtesë përdoret sipas formularit L19.

Autoriteti i Likuidimit në kërkesën drejtuar pretenduesit për informata ose dokumentacion shtesë, duhet të përfshijë vërejtjen se mosdorëzimi i informatave dhe dokumenteve të kërkuara brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës, do të rezultojë në refuzimin e kërkesës së tij nga Autoriteti i Likuidimit.

Autoriteti i Likuidimit (AL-ja), duhet të shqyrtojë nëse kërkesave iu ka kaluar afati i përcaktuar me ligj, dhe nëse kërkesat e tilla nuk janë sjellë në mënyrën dhe në afatin e duhur në Gjykatën që ka juridiksion ato do të refuzohen dhe nuk do të jenë të kualifikueshme që të marrin pjesë në ndonjë shpërndarje përmes likuidimit.

4. Trajtimi i kërkesave kreditore

Menjëherë pas afatit për parashtrimin e kërkesave, bazuar në nenin 9.4 të kësaj rregullore, AL do të vlerësojë validitetin dhe bazën e kërkesave dhe do të njoftojë pretenduesit për rezultatet e vlerësimit. Nëse kërkesat nuk janë të plota apo dëshmitë kanë mungesa, AL mund të kërkojë informatat dhe dëshmitë shtesë në afat prej 15 ditëve pas pranimit të kërkesës për afat shtesë. Më pas, nëse AL, refuzon, tërësisht apo pjesërisht, apo zvogëlon shumën e kërkesës së parashtruar, do të njoftojë kreditorët me shkrim, duke dhënë shpjegimin për refuzimin apo zvogëlimin e kërkesës. Vlerësimi i validitetit të secilës kërkesë do të ndodh brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi dhe kërkuarët do të njoftohen brenda pesë (5) ditësh nga vlerësimi nëse kërkesa është përfshirë në diagramin e borxheve të NSH-së.

5. Trajtimi i Kërkesave të parashtruara (afatet material të parashkrimit të kërkesave)

Sipas nenit 9.6.1 të Politikave operacionale në procedurën e likuidimit, konsiderohet se me parashkrim shuhet e drejta e kërkuarët të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Sa i përket parashkrimit, Autoriteti i Likuidimit duhet t’i referohet në tërësi Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në LMD janë paraparë afate të ndryshme kohore.

Mëvërsisht nga lloji i kërkesës kreditore LMD-ja në dispozitat përkatëse që rregullojnë parashkrimin e kërkesave ka përcaktuar edhe afatet e parashkrimit të kërkesave.

Për shembull të kërkesat e shërbimeve komunale 1 vitë, kërkesat periodike dhe ato që rrjedhin nga mardhëniet reciproke kontraktuale në mes personave juridik 3 vite, për një kategori tjetër të kërkesave 5 vite, e për kërkesat që rrjedhin nga vendimit e plotëfuqishme gjyqësore 10 vite.

6. Afati procedural i parashtrimit/dorëzimit të kërkesës

Afati për parashtrimin e kërkesave është përcaktuar në nenin 7 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë (45 ditë) duke u bërë thirrje të gjithë kreditorëve dhe bartësve të interesit që t'i parashtrojnë Dëshmitë e tyre të Kërkesës dhe Interesit.

Nëse një kreditor i supozuar apo bartës i interesit paraqet arsyetim bindës për parashtrim të vonuar, Autoriteti i Likuidimit, në diskrecion vetanak, mund të pranojë Dëshminë e Kërkesës apo Interesit të dorëzuar pas afatit për parashtrimin e kërkesave, nëse dëshmia e kërkesës apo Interesit është parashtruar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas afatit për parashtrimin e kërkesave. Në rastet e tilla Autoriteti i Likuidimit do të dërgoj kërkesë për arsyetim të vonesës në parashtrimin e kërkesës kreditore [formulari L18]. Kërkesat e parashtruara pas afatit do të refuzohen.

7. Kërkesat e pavlefshme dhe jo të rregullta

1. Pas përcaktimit të pranueshmërisë së kërkesave të ndërlidhura me nenin 23.1.1 dhe të shtojcës së këtij ligji, Autoriteti i Likuidimit merr në shqyrtim dhe refuzon, tërësisht apo pjesërisht, vlefshmërinë meritore të Kërkesave apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë nëse refuzimi i tillë obligohet apo lejohet sipas këtij ligji apo elementeve tjera të ligjeve të Kosovës në fuqi apo me urdhër të Gjykatës.

2. Pa kufizuar fushëveprimin apo zbatueshmërisë e paragrafit 1 më sipër, elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë:

2.1. kërkesa apo pretendimi është i pasafatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme;

2.2. dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese; apo

2.3. ndonjë aspekt i dokumentacionit të paraqitur është mashtrues apo ka dëshmi të mira dhe substanciale për të besuar se kërkesa apo interesi i pretenduar është mashtrues; apo

2.4. ka arsye për të besuar se transaksion:

2.4.1. nuk është aprovuar përmes procedurave të rregullta të brendshme të ndërmarrjes;

2.4.2. është ekzekutuar në emër të ndërmarrjes nga personi pa autoritet të vërtetë ligjor;

2.4.3. nuk do të ishte aprovuar nëse do të ishte parashtruar për aprovim të rregullt të brendshëm, përfshirë edhe kontratat që do të duhej të aprovohehin nga menaxhmenti apo një zyrtar i ndërmarrjes në kohën përkatëse, mirëpo të cilat nuk janë aprovuar;

2.4.4. në kohën përkatëse, është lidhur në kundërshtim me obligimin fiduciar apo obligimet tjera ndaj Ndërmarrjes apo palës së tretë nga Menaxhmenti apo Zyrtari sipas ligjit në fuqi në atë kohë; apo

2.4.5. ishte në kundërshtim me rregulloren e nxjerrë nga OKB-ja apo rregullore apo akte të ngjashme të nxjerra nga një organ i autorizuar nga Bashkimi Evropian; dhe, në secilin rast të saktësuar në pikët 2.4.1 – 2.4.5 më lart, kreditori apo kërkuesi i interesit ishin në dijeni apo, gjatë ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm profesional, do të duhej të ishin në dijeni të shkeljes, cenimit apo mungesës së autoritetit në fjalë.

2.5. në kohën që transaksioni është lidhur kreditori ishte në dijeni apo, gjatë ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm profesional, do të duhej të ishte në dijeni se Ndërmarrja ishte insolvente dhe se transaksioni ka rezultuar pasi që kreditori është vënë në pozitë më të favorshme sesa kreditorët e tjerë;

2.6. transaksioni është bërë në vlerë që është materialisht më e ulët sesa vlera aktuale e tregut në atë kohë;

2.7. pagesa apo furnizimi në lidhje me transaksionin ishte në shkelje të një apo më shumë rezolutash të Këshillit të Sigurimit të OKB-së apo Rregulloret e Këshillit të Bashkimit Evropian lidhur me imponimin e sanksioneve ndërkombëtare; apo

2.8. kërkesat që kanë të bëjnë me transaksionin që është kryer jashtë Kosovës:

2.8.1. ka të bëjë me një subjekt, apo subjekt apo njësi biznesi të supozuar e cila, në kohën e vendimit efektiv për likuidim, menaxhohet ndaras nga veprimtaria e ndërmarrjes në Kosovë dhe;

2.8.2. Autoriteti i Likuidimit ka përcaktuar se nuk është i mundur zbatimi i marrjen nën kontroll në emër të ndërmarrjes i pronës apo asetëve të atij subjekti. Të gjitha transaksionet e tilla të mbyllura në emër të ndërmarrjes përfshin transaksionet qëllimi afarist i të cilave është kufizuar në subjektin e pavarur apo njësinë e biznesit.

Autoriteti i Likuidimit do t'i kushtoj kujdes vlerësimit të transaksionit kundrejt kritereve të gjëra të specifikuar në Nenin 36 të Shtojcës së Ligjit. Nëse transaksioni është i anulueshëm sipas kritereve të mësipërme, atëherë edhe kërkesa kreditore e bazuar në atë transaksion duhet të refuzohet.

Kur kërkesat kreditore janë të paligjshme ose të falsifikuara, Agjencia ka kompetencë të shqiptoj sanksione administrative.

Në procedurën e likuidimit, për NSH-të që janë vendosur në likuidim pas datës 21 shtator 2011, kreditori duhet të parashtrij kërkesën brenda dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është publikuar në tërësi Njoftimi për likuidim në pajtim me të gjitha kërkesat e aplikueshme të Dispozitave për Shpallje.

Neni 43.3(d)(ii) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 i referohet të drejtës së ankuesit për të parashtruar kërkesat e tyre ekzistuese për kualifikueshmëri dy muaj pas publikimit të dytë të njoftimit për likuidim. Ky afat nuk është përfillur nga ankuesit pasi që asnjë publikim tjetër nuk është bërë. Publikimi i ligjit nuk mund të konsiderohet si publikim i njoftimit të likuidimit për kualifikueshmëri. Si shtesë, njoftimi për likuidim publikohet dy herë në gazetën e përditshme për të arritur në mënyrë efektive tek ankuesit potencial. Prandaj, të rastet e lartpërmendura të kërkesave për punë, i zbatueshëm do të jetë parashkrimi prej 3 viteve.

8. Ligji i aplikueshëm për transformimet e pretenduara të NSH-ve

Në procedura administrative tek Autoriteti i Likuidimit por edhe në procedura gjyqësore në DHPGJS ka shumë kërkesa të palëve të cilët pretendojnë se ata e kanë të drejtën e pronësisë në aksione të NSH-ve, mbi bazën e transformimeve të pretenduara të NSH-ve gjatë viteve 90-ta. Palët ofrojnë ndonjë dëshmi, por deri tani nuk ka asnjë shembull konkret që pala të ketë dëshmi valide për një transformim të tillë të statusit të NSH-së nga NSH në shoqëri aksionare.

Arsyet për këtë janë kriteret ligjore dhe procedura që kërkohen për një transformim të tillë, të cilat nuk janë vërtetuar se janë përmbyshur.

Fondi Zhvillimor si entitet ishte futur në Legjislacion, me Ligjin e ish RFSJ mbi Kapitalin Shoqëror (Gazeta Zyrtare e RSFJ 84/89, 46/90).

Ligji mbi Kapitalin Shoqëror i autorizonte ndërmarrjet me pronësi shoqërore “që të përvetësojnë kapital shtesë me anë të lëshimit të një sasive të aksioneve, më saktësisht nëpërmjet shitjes të aksioneve që u japin të drejtën apo titullin e pronësisë”. Përkufizimi i Kapitalit Shoqëror, siç parashihej në nenin 1 të këtij Ligji, janë asetet kapitale të një ndërmarrjeje të zhvlerësuara për pjesën proporcionale të humbjeve të pambuluara tregtare, fondeve rezervë dhe fondeve jashtë biznesit.

Me këtë ligj parashihej se kapitali shoqëror i NSH-ve, mund të shitet, plotësisht apo pjesërisht, investitorëve vendor apo të jashtëm me kusht që të hyrat e fituara nga kjo shitje i takojnë Fondit të themeluar për zhvillim.

Sipas neni 3 të këtij ligji, përcaktohej se të hyrat e fituara përmes shitjes të kapitalit shoqëror që kanalizohen tek fondi për zhvillim do të paraqesin një depozitë të vazhdueshme të ish Republikës apo ish Krahinës Autonome në Fondin për Zhvillim. Të ardhurat e fituara nga shitja e ndërmarrjeve (plotësisht apo pjesërisht) do të përdoren nga Fondi për Zhvillim për investime kapitale në ndërmarrje.

Me këtë ligj përcaktohej se lëshimi i aksioneve për shitje, si dhe shitja e ndërmarrjes e plotë apo e pjesërishtme, është e drejtë ekskluzive e organit Menaxhues të Ndërmarrjes. Me vendimin e brendshëm për shitjen e aksioneve (përgatitja e tyre për shitje për punëtorët aktual apo ish-punëtorët, personat tjerë fizik vendor apo fondet për sigurime pensionale dhe të invaliditetit) organi menaxhues duhet të merrte vendim për organizimin e ndërmarrjes në një formë qoftë si Shoqëri Aksionare apo Shoqëri me Përgjegjës të Kufizuara. Në rast se organi menaxhues i ndërmarrjes merr vendimin për shitjen e një pjese të ndërmarrjes, ai njëherësh merr edhe vendimin tjetër për organizimin e ndërmarrjes si ndërmarrje me pronësi të përzier.

Ligji mbi Kapitalin shoqëror përcaktonte se caktimi i vlerës së një ndërmarrjeje duhet të bëhet nga një organizatë e përzgjedhur nga ana e një Agjencie për Ristrukturim dhe Revitalizim, e cila është e themeluar në bazë të këtij ligji me qëllim të ofrimit të këshillave lidhur me shitjen e ndërmarrjes. Ligji kërkonte të merrej një opinion nga ana e kësaj Agjencie, para përmbylljes të kontratës që ka të bëjë me çfarëdo shitje të aksioneve, pjesë të ndërmarrjes apo vet ndërmarrjen. Ligji përcakton një afat prej 10 vitesh për përmbylljen e shitjes si dhe pagesën e aksioneve të brendshme të lëshuara nga ndërmarrja. Parapagimi apo pagesa e aksioneve duhet të dëshmohen nga Banka në fjalë përmes certifikatave të veçanta.

Ligji mbi Kapitalin Shoqëror u ndryshua në vitin 1996 (Gazeta Zyrtare e RSFJ 29/96, 29/97) për sa u përket ofrimit për herë të parë të mundësisë të transformimit përmes bartjes të aksioneve tek Fondi për Zhvillim apo në fondet tjera.

Transferimi i aksioneve, sa i përket nenit 13 të Ligjit në fjalë, është bërë për të vetmin qëllim që këto aksione të ofrohen për shitje për tregun kapital. Transferimi i aksioneve tek Fondi për Zhvillim, nëse është bërë ndonjëherë sipas nenit 13 të Ligjit, e bënte Fondin një lloj “bartësi” të aksioneve të blerësi, i cili pas kryerjes së pagesës bëhet pronar i padiskutueshëm/përfundimtar.

Një ndryshim i rëndësishëm, i bërë me këtë ligj, ishte e drejta e kompanisë për të hyrë në marrëveshje kontraktuale me kreditorët e saj për shndërrimin e shumave të detyrimeve (ndaj kreditorëve) në investim (të kreditorëve) dhe më pas kapitalizmin e një investimi të tillë në aksione.

9. Obligimi i regjistrimit në Gjykatë të ndërmarrjeve të transformuara

Çfarëdo ndryshimi i statusit të ndërmarrjes, por edhe ndryshime tjera, përfshirë ndryshimet në kapital, duhej të regjistroheshin në regjistrin e Gjykatës. Regjistrimi në Gjykatë ishte e vetmja mënyrë për t'i dhënë efekt ligjor transformimit të ndërmarrjes. Të dhënat e futura në Regjistrin e Gjykatës publikohen në Gazetën Zyrtare të RSFJ.

Përveç ligjit Federal për kapitalin shoqëror, edhe Republika e Serbisë kishte nxjerrë ligjin e vet lidhur me themelimin e Fondit për Zhvillim dhe procedurat për transformimin e pronës shoqërore. Ligji mbi Fondin Republikan për Zhvillim dhe Rindërtim të Ekonomisë, ishte nxjerrë nga Republika e Serbisë në vitin 1990. Aktiviteti i Fondit do të ishte investimi i kapitalit shoqëror dhe mjeteve tjera financiare në aksione apo pjesë të ndërmarrjes shoqërore, duke synuar konsolidimin e ndërmarrjeve të tilla, shitjet pasuese të aksioneve e pjesëve dhe rregullimin e krediteve.

Fondi Republikan për Zhvillim dhe Rindërtim të Ekonomisë, ka pushuar së funksionuari në vitin 1992, me ç'rast Kuvendi i Republikës të Serbisë miratoi Ligjin mbi Fondin Zhvillimor të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare e RS 20/92).

Procedura për transformimin e pronës shoqërore parashihej me “Ligjin mbi Kushtet dhe Procedurat për Transformimin e Pronës Shoqërore” (tani e tutje Ligji mbi Transformimet). Ligji mbi Transformimet përbëhet prej parimeve të vendosura nga Ligji i RSFJ mbi Kapitalin Shoqëror. Ligji parasheh transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri aksionare.

Ligji e mvesh Organin Menaxhues të ndërmarrjes me autoritet ekskluziv për të vendosur mbi transformimin e ndërmarrjeve në Shoqëri Aksionare si dhe për lëshimin e aksioneve.

Ndërmarrja ishte e obliguar me Ligj që të publikoj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë si dhe në shtypin ditor që të dyja, Vendimin e Organit Menaxhues lidhur me transformimin dhe Vendimin për Lëshimin e Aksioneve. Ishte paraparë që pronarët e kapitalit do të pranojnë një vërtetim për shumën e paguar të aksioneve.

Ligji parasheh tre mënyra të transformimit: Lëshimi dhe shitja e aksioneve me qëllim të shitjes të kapitalit në pronësi shoqërore; lëshimi i aksioneve me qëllim të rritjes të kapitalit dhe blerja e ndërmarrjes apo një pjese të saj.

Sipas metodës të parë të transformimit – shitja e kapitalit shoqëror përmes aksioneve – punëtorëve, ish-punëtorëve apo trashëgimtarëve të ish-punëtorëve të ndërmarrjes të kualifikohen për zbritje të vlerës nominale të aksioneve, ndërsa 50% e kapitalit të fituar nga shitja e aksioneve me zbritje shkon në Fondin Pensionsal.

Fondi për Zhvillim duket se ka pranuar vetëm 60% të kapitalit të fituar nëpërmjet shitjes të aksioneve pa zbritje, që janë para të mbledhura nga shitjet ndaj palëve të treta (që nuk janë punëtorë), ndërsa 30% e kapitalit shkonte në Fondin Pensionsal dhe 10% në Fondin për Punësim.

Kapitali i transferuar në Fondin për Zhvillim do të përdorej për prodhim, ristrukturim të pronës dhe zhvillim. Secila ndërmarrje e përfshirë duhej të mbante të dhënat e të gjitha aksioneve të shitura dhe zbritjeve të bëra.

Ligji parasheh një vlerësim të kapitalit që duhej bërë nga ana e Agjencisë, përderisa kapitali i fituar pas shitjes të aksioneve të tilla mbetet në pronësi të ndërmarrjes. Shitja e Ndërmarrjes, apo e një pjese të saj, si një formë tjetër e transformimit, bëhet përmes një ankandi publik me kushtet e vendosura nga Fondi për Zhvillim. Ndërmarrja bëhet pjesë e kontratës të shitjes vetëm nëse një pjesë e saj është shitur. Nëse vetëm nëse një pjesë e ndërmarrjes është shitur, ndryshe nga blerja e ndërmarrjes si e tërë, ku çmimi i shitjes paguhej në llogarinë bankare të Fondit për Zhvillim, paratë e paguara mbesin në ndërmarrje. Shitja e ndërmarrjes, megjithëse mund të përshij vetëm një pjesë të saj, shpie në likuidim.

Transformimi, pa marrë parasysh formën, duhet të kalonte për mes një Agjencie të specializuar. Kjo Agjenci do të lëshonte një vërtetim brenda 60 ditëve pas pranimit të vlerësimit të brendshëm të kapitalit shoqëror të NSH-së dhe zbritjen e aplikueshme përkatëse të vlerës të aksioneve. Procesi i lëshimit dhe i shitjes të aksioneve duhej të bëhet në bazë të Ligjit mbi rregullimin e aksioneve i cili është Ligji i RSFJ për letra me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89, 29/90).

Ligji i kërkonte Agjencisë Federale të Administratës, e cila është kompetente për çështjet financiare, që të mbante shënime për çfarëdo lëshimi të aksioneve apo letrave me vlerë.

Definicioni i aksioneve dhe letrave me vlerë, siç parashihet në nenin 1 dhe 8 të Ligjit, përcaktonte aksionet, fletë garancionet, letrat e thesarit, dëftesat dhe certifikatat komerciale të cilat janë dokumente në formë të shkruar të regjistruara apo të krijuara për bartësin.

Çfarëdo e drejte apo detyrimi të parapara në aksione apo obligacione hynte në fuqi posa Lëshuesi i dorëzon ato te blerësi. Ligji kujdeset posaçërisht për aksionet e lëshuara nga ndërmarrja apo subjektet tjera përfituese në nenet 13-25. Sipas nenit 15, ligji parasheh që aksionet duhej të paguheshin me para, apo mallra ose të drejtat e shprehura në shuma financiare, nëse vendimi për lëshimin e aksioneve ka paraparë ashtu.

Këshilli i Punëtorëve i Ndërmarrjeve shoqërore merrte vendim për lëshimin e aksioneve.

Vendimi mbi lëshimin e aksioneve duhet të përmbaj një sërë elementesh të specifikuar në nenin 20 të ligjit në fjalë: një të dhënë që tregon se aksionet janë lëshuar tek bartësi apo se ato janë regjistruar; shumën e përgjithshme dhe numrin e aksioneve; vlerën nominale të aksioneve; numrin e votave për aksion në organin menaxhues; metodën e pagesës të ndarë; kohën e regjistrimit të aksioneve; metodën e regjistrimit; kohën dhe metodën e pagesës të aksioneve; afatin për rimbursim në rast të ndonjë dështimi; llojin e aksioneve që do të lëshohen; renditja e realizimit të drejtave me prioritet në rastet kur kemi më shumë se një lëshim; metodën e njoftimit; procedurat e shpërndarjes; mënyrën e shpërndarjes; specifikacionet lidhur me kushtet e pagesës të dividendit të akumuluar; bartja e rrezikut; mënyra e shitjes të aksioneve; mundësia për shndërrim; të drejtat e bartësit për aksionet me prioritet; drejtat e me prioritet për bartësin në rast të lëshimit të ri; etj.

Aksionet e lëshuara nga ndërmarrja përbëheshin nga dy komponentë: dokumenti për lëshimin e aksioneve dhe kuponi për mbledhjen e dividendëve.

10. Përbushja e detyrimeve që dalin apo që ndërlidhen me aksionet

Kërkesa e dytë ligjore e paraparë me Ligjin e AKP-së (sipas nën-paragrafit 4.2 të nenit 5), përcakton se për të qenë transformimi i vlefshëm I ndërrmarrjeve shoqërore, duhet përbushur të gjitha obligimet përfshirë, por duke mos u kufizuar në, pagesën apo lëshimin e aksioneve në fjalë. Përderisa obligimet që lidhen me lëshimin e aksioneve janë trajtuar gjerësisht më sipër, kjo pjesë do të trajtoj çështjen e pagesës të aksioneve siç parakusht për transformimin e NSH-së në Shoqëri Aksionare.

Pagesa e Aksioneve ka qenë gjithashtu parakusht për transformimin sipas ligjit të aplikueshëm të kohës.

Aksionet e lëshuara nga një NSH mund të paguheshin përnjëherë apo edhe në këste. Në rast të pagesës me këste, atëherë bartësi ka pranuar vetëm aksione të përkohshme deri në pagesën përfundimtare. Sidoqoftë, ka pasur një afat kohor për pagesën e aksioneve të përcaktuar në Memorandumin e Shoqatës të Shoqërisë Aksionare, dhe se në rast dështimi për të bërë pagesën, praktikisht kjo ka quar në ndërprerjen e financimit të SH.A. Ligji parasheh që certifikata të lëshohet nga banka në të cilën është bërë pagesa e aksioneve.

Aksionet mundën gjithashtu të përdoren për përbushjen e obligimeve të një NSH-je nën çfarëdo kushti që pajtohen bartësi dhe ndërrmarrja. Në këtë rast, marrëveshje për kryerjen e obligimeve me aksione duhet shoqëruar me certifikatën e marrëveshjes apo ndonjë dokument tjetër që mund të dëshmoj përbushjen në fjalë sipas një marrëveshjeje të tillë.

11. A ishte transformimi diskriminues dhe a janë shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Transformimi i NSH-ve është bërë në kohën e një klime me trazira politike, mosbesimi në mes të popullatës dhe njësive federale të ish-Jugosllavisë që dërguan në ndezjen e luftës dhe shpërbërjen e mëtejshme të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Objektivi politik i Fondit, siç përcaktohet me Ligjin mbi Fondi për Zhvillim të Republikës të Serbisë (Gazeta Zyrtare e RS 20/92), ishte “parandalim për emigrimin e mëtejshëm dhe kthimin e Serbëve dhe Malazezëve në Kosovë”¹¹⁹. Ndërsa ky dokument nuk merr përsipër të interpretoj nëse një dispozitë e tillë mund të sugjeronte konotacion diskriminues të këtij ligji të veçantë, ne duhet të theksojmë se ligjislacioni mbi transformimin ishte paraprirë apo i shoqëruar nga një legjislacion diskriminues.

Rregullorja e aplikueshme e UNMIK-ut 1999/24 “mbi ligjin e aplikueshëm në Kosovë” me ndryshime, neni 1, përcakton si në vijim: 1.1 Ligji në fuqi në Kosovë përfshin: (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to; dhe (b) Legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotërojnë rregulloret dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to.

Në qoftë se një gjykatë e juridiksionit kompetent, një organ ose një person që duhet të zbatoj një dispozitë të legjislacionit, konstaton se një çështje ose një situatë nuk mund të mbulohet nga legjislacioni i përcaktuar në paragrafin

1.1 të kësaj rregulloreje, por mbulohet nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe është në përputhje me nenin 1.3 të kësaj rregulloreje, atëherë gjykata, organi ose personi, si përjashtim, e zbaton atë ligj”.

Rregullorja e UNMIK–ut 1999/24 parasheh që një dispozitë apo ligj në fuqi nga marsi i vitit 1989 deri në qershor të vitit 1999, mund të zbatohet vetëm nëse nuk është diskriminuese.

Legjislacioni diskriminues në Kosovë ishte miratuar në një atmosferë politike pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës dhe Kuvendit të saj, si dhe heqjes të institucioneve autonome. Organet e Dhunshme ishin instaluar nga ana e autoriteteve shtetërore të Serbisë në të gjitha institucionet qeveritare, ndërmarrjet dhe ndërmarrjet shoqërore.

Shembuj evident të legjislacionit që inspironin dhe që kishin për qëllim diskriminimin nacional ishin Ligji mbi Marrëdhënien e Punës në rrethana të veçanta (Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 26 e datës korrik 1990) apo edhe Ligji mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në ndërmarrje (Gazeta Zyrtare e RS 43/90). Këto Ligje nënkuptonin instalimin e Masave të Dhunshme që mëtonin ndërrimin e autoriteteve menaxhuese në NSH me “organe të dhunshme”. Largimi nga puna e drejtorëve shqiptarë ishte veprimi i parë, ndërsa në fund zëvendësimi i tyre me qytetar etnik serbë rezultoi me largimin nga puna të punonjësve shqiptarë.

Natyra diskriminuese e një sërë ligjesh që ndërlidhen me transformimin dhe të drejtat e punëtorëve të NSH-ve ishte vënë re në masë të madhe nga organet përgjegjëse ndërkombëtare, siç janë OSBE dhe Komisioni mbi të drejtat e Njeriut i KB bazuar në raportet e përgatitura nga ta mbi situatën në Kosovë.

Në mënyrë që transformimi i NSH-ve të jetë i vlefshëm, në mënyrë absolute është e domosdoshme që ai të mos jenë vendosur nga organet menaxhuese nëpërmjet zbatimit të Ligji mbi Marrëdhënien e Punës në Rrethana të Veçanta (Gazeta Zyrtare e Serbisë 40/90 e datës korrik 1990), Ligji mbi Zbatimin e Masave të Dhunshme në NSH (Gazeta Zyrtare e RS 43/90), apo në ndonjë mënyrë tjetër i ndikuar nga ligjet diskriminuese të nxjerra ndërmjet marsit 1989 dhe qershorit 1999.

Pajtueshmëria me parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (Konventa) buron nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila e bën drejtpërdrejt të zbatueshme Konventën e cekur në Kosovë.

Konventa nuk ka qenë drejtpërdrejt e zbatueshme në kohën e transformimit të ndërmarrjeve shoqërore pasi që RSFJ, nuk ishte anëtare e Këshillit të Evropës dhe prandaj nuk e kishte ratifikuar atë.

12. Llogaritja nga ana e Agjencisë e “fondeve tepricë” në procedurë të likuidimit

Rregullorja për politika operacionale në procedurën e likuidimit ka paraparë edhe mundësinë që Agjencia të obligohet që të llogaritë “fondet tepricë” (nëse ka) për secilin likuidim të nisur nga Agjencia, sipas Ligjit të AKP-së apo sipas dispozitave analoge të legjislacionit paraprak deri në ligjin aktual “Fondet Tepricë” llogariten duke i mbledhur të ardhurat e privatizimit dhe likuidimit përfshirë çfarëdo të ardhurash tjera anësore, si qiraja ose ndonjë gjenerim tjetër, pastaj duke e zbritur: 20% për punëtorët e kualifikuar;

Pagesa 5% në emër të shpenzimeve administrative për Agjencinë; Vlerën maksimale të kërkesave dhe interesave të pronësisë së kërkuar dhe Shpenzimet e parapara të likuidimit.

Pasi të jenë kryer përlllogaritjet e paraqitura më lartë, 25% zbriten nga “fondet tepricë” si mbrojtje ndaj ndonjë gabimi të mundshëm. Llogaritja është ilustruar si në vijim: Nëse fondi tepricë është i dukshëm nga përlllogaritjet e mësipërme, Agjencia përcakton dhe deklaron si “fonde tepricë” deri në shtatëdhjetë e pesë përqind (75%)¹²⁹ dhe menjëherë i transferon ato fonde tepricë në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, të cilat pastaj bëhen “para publike” dhe trajtohen në pajtim me Ligjin për menagjimin e parave publike, dhe të cilat fonde do të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik të vendit, me aprovim të Kuvendit të Kosovës.

Në praktikë, kalkulimet e sipërshënuara mund të kryhen vetëm pas datës për parashtrimin e kërkesave kreditore.

13. Kthimi i fondeve të likuidimit nga Qeveria e Kosovës

Në rast se shuma e mbetur në një fond të mirëbesimit, nga i cili fondet tepricës janë transferuar në Qeveri sipas Ligjit të AKP-së nenit 19 paragrafit 3.3 (fondet tepricë të likuidimit) apo nenit 2 paragrafit 2.6 (fondet e mbetura të likuidimit) apo nenit 2 paragrafit 2.7 (fondet e përkohshme të likuidimit), është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme, AKP-ja e njofton Qeverinë për këtë dhe Qeveria brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike do t'i kthej fondet përkatëse, në fondin e mirëbesimit nga i cili më herët janë transferuar.

14. Shpërndarjet për kreditorët e NSH-ve

Secila kërkesë kreditore e parashtruar kundër një NSH-je të veçantë paguhet vetëm nga fondet e gjeneruara nga likuidimi i aseteve të NSH-së përkatëse. Pagesa fillon pas miratimit nga Bordi. Të gjitha pagesat për trajtimin e kërkesave kreditore do t'u nënshtrohen procedurave të vendosura nga Agjencia në pajtueshmëri me politikat financiare të AKP-së. Sipas nenit 41 të Shtojcës së Ligjit, kërkesat dhe interesat trajtohen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë dhe radhës të përcaktuar me nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së. Trajtimi e kërkesave dhe interesave që i përkasin një kategorie pasuese të prioritetit më të ulët mund të iniciohen vetëm pas përmbushjes së plotë dhe të tërësishme të kërkesave të kategorisë së mëhershme të prioritetit më të lartë.

Nëse resurset janë të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat e një kategorie të caktuar, duke përfshirë mbulimin për rezervimet e bëra nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo renditje, Autoriteti i Likuidimit mund të kërkoj nga Bordi miratimin për shpërndarje të parakohshme për kreditorët.

Nëse resurset janë të pamjaftueshme për të përmbushur tërësisht të gjitha Kërkesat apo interesat e një kategorie apo niveli të caktuar, përfshirë mbulimin për rezervimet e Autoritetit të Likuidimit për kërkesat e kontestuara të një kategorie apo niveli,

Kërkesat e asaj kategorie apo niveli përmbushen në proporcion me shumën e çdo Kërkese, përfshirë kërkesat për të cilat Autoriteti i Likuidimit ka bërë rezervime, sic përcaktohet në nenin 41.4 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së dhe në ndërlidhje me nenin 42 (Fondet e Rezervuara) të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Nuk duhet të bëhet asnjë shpërndarje derisa “Raporti i Rezultatit të Parashikuar” dhe “Analiza Përmbledhëse e Shpërndarjes” të tregojnë se a është e sigurt të veprohet në një mënyrë të tillë. Këto tregojnë nëse burimet e rasteve të likuidimit janë të mjaftueshme për të përmbushur plotësisht apo pjesërisht kategoritë e kërkesave kreditore.

15. Shpërndarja përfundimtare për kreditorët e NSH-ve

Pas marrjes së një vendimi përfundimtar nga ana e DHPGJS-së në lidhje me ankesat e kreditorëve të paraqitura ndaj vendimeve refuzuese në procedurën e Likuidimit, AL-ja përgatit Raportin e rezultatit të parashikuar në lidhje me fondet e mbetura dhe bënë shpërndarjen për kreditorët si dhe shpenzimet e papaguara të AL-së deri në atë moment. Në rast se mbesin të ardhura nga likuidimi i një NSH-je pasi të jenë zgjidhur të gjitha kërkesat/ankesat e kreditorëve, këto të ardhura transferohen në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës si fonde të mbetura të likuidimit.

16. Raporti përfundimtar i përmbylljes së NSH-së në likuidim

Autoriteti i Likuidimit brenda 60 ditësh kalendarike pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron për informim Raportin përfundimtar, Bordit të Drejtorëve, para se të dorëzohet ky raport në Gjykatë (DHPGJS) nga Autoriteti i Likuidimit në pajtim me nenin 43 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në.

17. Veprimet pas dorëzimit të kërkesës në DHPGJS për mbyllje të NSH-së

DHPGJS-ja pas pranimit të Raportit Përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit dhe parashtrimit të kërkesës për përmbyllje, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nxjerr një urdhër të shkruar për mbylljen e procesit të likuidimit, nëse është përmbushur ashtu që e gjithë prona dhe asetet e NSH-së janë likuiduar në atë masë, që është arsyeshëm e praktikueshme dhe të gjitha fondet e realizuara të jenë paguar apo janë paguar në mënyrë substanciale.

Nëse DHPGJS e kundërshton raportin përfundimtar, atëherë AL përgjigjet në kundërshtim dhe e dorëzon atë në gjykatë brenda 30 ditëve pas mocionit të gjykatës, apo brenda kohës së cekur në udhëzimin nga DHPGJS-ja.

DHPGJS-ja shënon në çdo urdhër dispozitën për përmbylljen e procedurës së Likuidimit për lirimin e AL ndaj ndonjë obligimi të mëtutjeshëm në lidhje me NSH-në dhe me procedurat e likuidimit.

Gjykata sipas detyrës zyrtare, pas shqyrtimit mund të kundërshtojë raportin përfundimtar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të dorëzimit. Nëse dërgohet njoftimi për kundërshtim, Autoriteti i Likuidimit përgjigjet në kundërshtim dhe e dorëzon atë në gjykatë brenda tridhjetë (30) ditëve pas mocionit të gjykatës apo brenda kohës së cekur në udhëzimin nga gjykata.

18. Mbyllja e rastit të ekspedituar të likuidimit

Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, në çdo fazë të procedurës, nëse përcaktohet se të hyrat në fjalë janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e kërkesave prioritare të përcaktuara në Ligjin e AKP-së dhe Shtojcën e tij, neni 40, paragrafi 1, nënparagrafi (1), Gjykata nxjerr vendim për lejimin për mbylljen e rastit të likuidimit.

Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, nëse asnjë kreditor nuk ka parashtruar kërkesë brenda afatit për parashtrimin e kërkesave, Gjykata nxjerr vendim për lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit. Nëse NSH-ja në likuidim nuk ka alete të realizueshme, AL kërkon miratimin e Bordit për të parashtruar kërkesën në gjykatë për aprovimin e mbylljes së rastit. Pas mbylljes së rastit të likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojcës së Ligjit, ndërpritet ligjrishtë ekzistimi i Ndërmarrjes dhe Agjencia (*Zyrtari i Rastit në emër të AL-së*) lëshon njoftim [formulari L31] me shkrim lidhur me këtë për Komunën përkatëse, gjykatat përkatëse, Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve Kosovare, Regjistrin e Pengjeve të Kosovës, Regjistrin e Hipotekave në Kosovë, Agjencinë Kadastrale të Kosovës, bankën(at) e ndërmarrjes, Administratën Tatimore, Ofruesit e Shërbimeve Publike në nivel Qendror dhe Lokal.

Autoriteti i Likuidimit brenda pesë (5) ditëve do të shpall në faqen zyrtare të internetit të Agjensisë, Raportin Përfundimtar të aprovuar nga Gjykata për mbylljen e rastit të likuidimit të ndërmarrjes. Mbyllja e likuidimit të NSH-së ndodh në datën kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të AL.

III. Pezullimi i procedurave gjyqësore pas vendimit të bordit për fillimin e procedurës së likuidimit

Edhe nëse një kërkesë është parashtruar paraprakisht në gjykatë nëse në një NSH ka filluar procesi i likuidimit, pas njoftimit nga AKP për fillimin e këtij procesi, gjykata duhet t'i pezulloj këto procedura në gjykatë dhe ta udhëzoj palën që kërkesat e tij t'i realizoj në proces të likuidimit. Sipas nenit 10 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, vendimi i Bordit të AKP-së, për fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së, prodhon efekte ligjore ndaj procedurave gjyqësore që kanë filluar më herët ndaj NSH-së që ka hyrë në likuidim. AKP-ja e njofton DHPGJSK-në për vendimin e Bordit për Likuidim të NSH-së, dhe kërkon nga gjykata që të pezullohen të gjitha procedurat gjyqësore të cilat kanë filluar më herët në bazë të padive të kreditorëve të supozuar të NSH-së në likuidim.

Neni 10.1 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së nuk bën dallim mes kërkesave kreditore dhe atyre pronësore, për të cilat ka filluar procedura gjyqësore. AKP-ja në njoftimin që ia bën gjykatës lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së, gjithmonë kërkon të pezullohen të gjitha procedurat gjyqësore, pavarësisht a bëhet fjalë për kërkesa kreditore apo për kërkesa pronësore.

Kolegjet gjyqësore të DHPGJS-së duke interpretuar dhe zbatuar këtë dispozitë ligjore kanë bërë dallimin në mes kërkesave kreditore dhe atyre pronësore.

Për një kohë relativisht të gjatë DHPGJS-ja i ka pezulluar të gjitha procedurat gjyqësore, përfshirë edhe për kërkesat pronësore. Pas një vendimi të Kolegjit të Apelit të marrë në vitin 2014, filloi të ndryshohet jurisprudenca e DHPGJS lidhur me paditë pronësore. Nga ky vit në bazë të jurisprudencës së re të Kolegjit të Apelit, paditë pronësore asnjëherë nuk janë pezulluar edhe pse ndaj NSH-së ka filluar procedura e likuidimit. Kjo qasje e Kolegjit të Apelit është argumentuar se pezullimi i procedurës tek lëndët pronësore, në fakt mund të qon deri te mohimi i të drejtave të pretenduara pronësore të kreditorëve, dhe nëse lejohet që këto prona të shiten në procedurën e likuidimit, atëherë kreditorët e NSH-së nuk do të kenë mundësinë të kthejnë pronat e pretenduara dhe kjo paraqet mohim i të drejtës së pronësisë dhe shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane mbi të drejtat dhe lirit e njeriut.

Megjithatë Kolegji i Apelit në dhjetor 2016 ka filluar të mendoj për ndërrimin e qasjes së deritanishme lidhur me paditë pronësore.

Kolegji i Apelit në dhjetor të vitit 2016, ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese të jep një interpretim dhe të vlerësoj kushtetutshmërinë e nenit 10 dhe nenit 40.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, nëse këto dispozita janë në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (mbrojtja e pronës).

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin në rastin nr. KO 142/16 të datës 18.07.2017, vlerëson se neni 10 dhe neni 40.1.5 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese në pikën 82 të Aktgjykimit të cekur ka konstatuar se

“nenet 10 dhe 40.1.5 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në nuk cenojnë thelbin e të drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave dhe mbrojtjes së pronës së kreditorëve sepse:

(i) kufizimi është paraparë me ligj të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

(ii) kufizimi është objektiv dhe i arsyeshëm sepse parandalon shkaktimin e konfuzionit që dot të krijohet nga zhvillimi i procedurave paralele në gjykatën referuese dhe tek Autoriteti i Likuidimit; dhe

(iii) parimi i proporcionalitetit zbatohet sepse pas përqendrimit fillestar të procedurave tek Autoriteti i Likuidimit- me qëllim të shmangies së procedurave paralele ofrohen garanci procedurale për ti kontestuar vendimet e Autoritetit të Likuidimit tek Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (në dy shkallë brenda kësaj Dhome).”, ndërsa në pikën 84 të këtij Aktgjykimi Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se “Gjykata konsideron se kjo përforcon garancitë për mbrojtje gjyqësore të të drejtave pronësore duke përfshirë edhe pretendimet e kreditorëve gjatë procesit të likuidimit të NSH-ve.”

Pas këtij Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Apelit ka rishqyrtuar mundësinë e pezullimit të procedurave gjyqësore edhe për paditë pronësore, duke filluar të ndërtojë kritere se kur mund të bëhet kjo tek paditë pronësore.

Në praktikën gjyqësore të DHPGJSK-së ka dualizëm të procedurave gjyqësore për kërkesat e njëjta pronësore ndaj NSH-së në likuidim. Ka procedura gjyqësore që kanë filluar para se NSH-ja të hyj në likuidim dhe procedura gjyqësore që kanë filluar në bazë të ankesave të paraqitura ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.

Në këtë dualizëm të këtyre procedurave gjyqësore Kolegji i Apelit ka filluar të ndërtojë kritere dhe mbi bazën e tyre nga rasti në rast të vendos nëse duhet pezulluar procedura gjyqësore që ka filluar më herët para se NSH-ja të hyj në likuidim dhe të vazhdohet me procedurën që ka filluar me ankesën e paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit, i cili ka refuzuar kërkesën pronësore në procedurën administrative pranë Autoritetit të Likuidimit. Tek lëndët e vjetra dhe tek ato që kanë arritur një stad të lartë të zhvillimit procedural, në bazë të praktikës ekzistuese të Kolegjit të Apelit dhe pas Aktgjykimit të cekur të Gjykatës Kushtetuese ende nuk pezullohet dhe vazhdon procedura paralele me procedurat që ka filluar më vonë në bazë të ankesës ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit mban qëndrim ligjor se tek procedura paralele për kërkesa të njëjta pronësore, rezultati i dhënë përfundimtar i njëjës procedurë ndikon në rezultatin e procedurës tjetër paralele. Përkatesisht përfundimi i njëjës procedurë ndikon që të përfundohet edhe procedura tjetër gjyqësore në DHPGJS.

Duhet theksuar se në bazë të nenit 10.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së procedurat e pezulluara gjyqësore pavarësisht natyrës së kërkesës së kreditorëve mund të vazhdojnë me leje të Autoritetit të Likuidimit apo të gjykatës. Sipas nenit 10.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së edhe nëse është në likuidim një NSH, ndaj saj nuk do të pezullohen procedura gjyqësore që në emër të NSH-së drejtohen kundër palëve të treta, procedurat penale ndaj ndërmarrjes apo menaxhmentit të saj, procedurat lidhur me transferimin apo disponimin me asetet e ndërmarrjes gjatë rrjedhës së rregullt të punës së ndërmarrjes, procedurat që kanë të bëjnë me parandalimin apo korrigjimin e shkeljeve të dispozitave rregullative, rregullave apo vendimeve nëse ato nuk pretendojnë pretendime monetare dhe procedurat lidhur me inspektimet dhe kërkesat për inspektim të parashtruara nga bartësit hipotekar të regjistruara, garancive të vërtetuara apo pengjeve që kanë të bëjnë me asete të ndërmarrjeve.

Iv. Procedura e trajtimit të kërkesave kreditore dhe pronësore tek autoriteti i likuidimit dhe në DHPGJS

Këto kërkesa kreditore apo pronësore fillimisht trajtohen nga AL pasi të kthe filluar procesi i likuidimit të NSH-së. Madje, siç u tha më lartë, konform nenit 10 të Ligjit të AKP-së të gjitha procedura gjyqësore duhet të ndërpriten nga momenti i njoftimit të AKP-së se një NSH ka hyrë në proces të likuidimit. Qëllimi i kësaj është që të gjitha kërkesat eventuale kreditore e pronësore të trajtohen fillimisht nga AL.

AL këto procedura administrative i zhvillon bazuar në Ligjin e AKP-së dhe Rregulloren nr. 4/2020 që është nxjerrë në pajtim me nenet 9 dhe 15.2.1 të Ligjit të AKP-së. Qëllimi primar i kësaj rregulloreje është që të pajis personelin e AKP-së dhe palët e interesuara me një sistem që lehtëson mbarvajtjen e procesit të likuidimit dhe procedura për vendimmarrje efektive dhe efikase gjatë këtij procesi të likuidimit të NSH-ve.

Me këtë rregullore është mundësuar që e gjithë procedura e likuidimit të zhvillohet në përputhje me mligjin dhe me praktikën e standardeve ndërkombëtare të insolvencës. Këto standarde , formularë, njoftime dhe dokumente tjera që janë pjesë e sistemit të AKP-së shërbejnë për menaxhimin e procesit të likuidimit. Është me rëndësi të ceket se kjo rregullore nuk ka të bëjë me kërkesat e punëtorëve lidhur me 20 për qindshin, sepse shpeshherë palët i ngatërrojnë këto dy procedura.

Ndaj vendimeve të AL-së palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë në DHPGJSK. Në këtë gjykatë këto kërkesa trajtohen në dy instanca gjyqësore.

Procedurat gjyqësore lidhur me ankesat e paraqitura ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit zhvilloheshin në pajtim me rregullat procedurale të përcaktuara me Shtojcës e LDHP-së, përkatësisht të rregullave të veçanta të përcaktuara me nenin 69 dhe 70 të kësaj Shtojce. Aktualisht këto procedura zhvillohen në pajtim me nenin 74 dhe 75 të Ligjit të DHPGJSK-së.

Në bazë të nenit 74.2 të LDHP-së dhe nenit 37.7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, çdo kreditor i supozuar i ndërmarrjes i cili me kohë e ka dorëzuar kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i Autoritetit të Likuidimit mund të parashtrorë kundërshtim kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Bazuar në nenin 74.4 të LDHP-së të gjitha rregullat procedurale të kësaj shtojce të parapara me nenet 13-67 do të zbatohen në procedurat e shqyrtimit të ankesave të paraqitura ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.

Ankesat ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit lidhur me kërkesat pronësore dhe kreditore në DHPGJS shqyrtohen nga dy shkallët vendimmarrëse nga Kolegjet e Specializuara në Shkallën e parë dhe nga Kolegji i Apelit në shkallën e dytë. Në bazë të një vendimi të Presidiumi, me lëndë të tilla janë ngarkuar të gjitha kolegjet e specializuara për qëllime të krijimit të një balance të punës mes kolegjeve. Përndryshe Kolegji IV i Specializuar në bazë të Shtojcës së LDHP-së është Kolegji kompetent që merret me ankesat e paraqitura ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.

Rregullat procedurale mbi afatet, kriteret e pranueshmërisë, mbi procedurën me shkrim dhe procedurën verbale përshtatshëmish zbatohet edhe për ankesat e paraqitura ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.

Ankesat e tilla pasi të regjistrohen nga zyra e regjistrimit i barten gjyqtarit përkatës në punë, i cili si për çdo padi tjetër edhe për këto ankesa fillimisht e shqyrton kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 25,27 dhe 28.2 të Shtojcës së LDHP-së.

Nëse një ankesë e tillë nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, Kolegji i Specializuar e hedh poshtë si të papranueshme. Në të kundërtën nëse këto ankesa i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë atëherë shqyrtohen meritat e ankesës.

Neni 74.2 i Ligjit të LDHP-së ka përcaktuar obligimin e ankuesit që bashkë me ankesë të bashkëngjis edhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit ndaj të cilit ka bërë ankesë.

Në praktikën gjyqësore të DHPGJSK-së ka pasur qëndrime të ndryshme ligjore, nëse ankuesi nuk e dorëzon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit në DHPGJS, a paraqet kriter të pranueshmërisë së ankesës.

Kolegjet e Specializuara kanë vlerësuar se mos dorëzimi vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit paraqet kriter të pranueshmërisë, edhe pse ky kriter nuk përmendet tek neni 28.2 i Shtojcës së LDHP-së i cili nen i rregullon kriteret e pranueshmërisë së padisë. Kolegji i Apelit për një kohë të gjatë mos dorëzimin e vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit nuk e ka konsideruar si kriter të pranueshmërisë, pasi që ky kriter nuk është përcaktuar shprehimisht tek neni 28.2 i Shtojcës. Kolegji i Apelit ka vlerësuar se neni 70.2 i Shtojcës i cili e obligon ankuesin ta sjellë vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, nuk ka përcaktuar pasoja ligjore nëse ankuesi ka dështuar të sjellë këtë vendim. Mirëpo më vonë kjo qasje e Kolegjit të Apelit me Aktgjykimin AC-I_14-0201, AC-I-14-0224, AC-I-15-0046, e ka ndryshuar qasjen e deri tanishme dhe tashmë Kolegji i Apelit konsideron se nëse ankuesi nuk e dorëzon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, edhe pse është kërkuar të dorëzohet ankesa do të hedhet poshtë si e papranueshme. Një qasje e tillë e Kolegjit të Apelit e ka konsoliduar jurisprudencën e DHPGJS-së në këtë pikë.

Poqëse ankesa e paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, Kolegji i Specializuar e shqyrton ankesën në merita, dhe atë përmes procedurës me shkrim dhe asaj verbale.

Ankuesi e ka barrën e të provuarit dhe ai duhet ta mbështet ankesën me dëshmitë dhe provat relevante.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur lidhur me këto ankesa, nëse nuk e hudh poshtë ankesën për shkaqe procedurale ajo nxjerr Aktgjykim me të cilin vërtetohet, shfuqizohet ose ndryshohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Në rast se e shfuqizon- e prish vendimin e ankimuar të Autoriteti të Likuidimit, lënda nuk do të kthehet tek Autoriteti i Likuidimit por Kolegji i Specializuar do të vendos vet lidhur me meritat e ankesës. Një qëndrim të tillë ligjor Kolegji i Apelit e ka marrë në një rast nga praktika e vet gjyqësore kur e ka prishur një Aktgjykim të ankimuar të Kolegjit të Specializuar i cili Aktgjykim lëndën kishte vendosur ta kthej tek Autoriteti i Likuidimit. Argumenti ligjor i Kolegjit të Apelit është se rregullat procedurale të Shtojcës së LDHP-së nuk mundësojnë kthimin e lëndës tek Autoriteti i Likuidimit në rast se prishet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

1. Procedurat ankimore pranë kolegjit të apelit

Rregullat e procedurës ankimore të parapara për lëndët tjera të cilat i mbulon jurisdiksioni i DHPGJS-së, zbatohen përshtatshmërisht edhe për ankesat e paraqitura ndaj vendimeve të Kolegjeve të Specializuara me të cilat është vendosur lidhur me ankesat e paraqitura ndaj vendimeve të Autoritetit të Likuidimit.

Ankesat e këtilla në procedurën ankimore i nënshtrohen fillimisht vlerësimit nëse ato i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë dhe pastaj nëse këto kritere janë plotësuar vlerësohet meritat e ankesës.

Ankesat e paafatshme apo ato të cilat nuk i plotësojnë kriteret tjera të pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 36 të LDHP-së dhe nenin 74.2 të këtij ligji, hedhen poshtë si të papranueshme.

Nëse ankesa nuk është hedhur poshtë si e pa pranueshme atëherë çdo ankesë në këtë fazë të procedurës shqyrtohet në merita përmes procedurës me shkrim të përcaktuar me nenin 67 të LDHP-së ankesa dërgohet për përgjigje në ankesë. Procedura me shkrim do të mbyllet pas veprimeve procedurale dhe afateve të përcaktuara me nenin 68 të LDHP-së.

Kolegji i Apelit në bazë të nenit 69 të LDHP-së ka mundësi të zbatoj edhe procedurën ankimore verbale duke caktuar seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore në procedurën ankimore bëhen me nismën e Kolegjit të Apelit dhe në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë në procedurë e cila duhet të paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë duhet parashtruar para procedurave me shkrim të ankesës. Rregullat për rrjedhën e seancën dëgjimore në Kolegjin e Apelit janë të njëjta me rregullat e përcaktuara për seancë në Kolegjin e Specializuar.

Neni 70 i LDHP-së ka përcaktuar mundësin ligjore që pala në ankesë të paraqet edhe prova të reja gjatë procedurës ankimore lidhur me kërkesën e tij. Nëse paraqiten prova të reja atëherë pala duhet të japë arsye pse këto prova nuk i ka pasur në disponim në procedurën para Kolegjit të Specializuar. Nëse ka një kërkesë të tillë për prova të reja atëherë ajo parashtrues duhet ti dërgohet palës tjetër 15 ditë para datës së seancës në mënyrë që të jetë e njoftuar për këtë kërkesë dhe të ketë mundësinë për komente.

Kolegji i Apelit mund të aprovoj kërkesën për prova të reja nëse vlerëson se kjo do të jetë në interesin e drejtësisë.

Kolegji i Apelit duke vendosur në meritat e ankesës, Aktgjykimin e ankimuar të Kolegjit të Specializuar mund ta vërtetoj, ta ndryshoj apo ta prish dhe lëndën ta kthej më rigjykim.

Bazuar në nenin 10.11 nënpika 11.1 të LDHP-së Kolegji i Apelit nuk mund ta prish Aktgjykimin e shkallës së parë duke ndërruar gjendjen faktike të bërë nga gjykata e shkallës së parë përveç nëse Kolegji i Apelit përcakton që ajo gjetje faktike është qartësisht e gabueshme.

Procedura ankimore edhe në lëndët e kësaj natyre mbyllet me një Aktgjykim përkatësisht Aktvendim të Kolegjit të Apelit i cili në bazë të nenit 10.14 të LDHP-së është i formës së prerë dhe ndaj të cilit nuk ka mundësi të paraqiten mjete të jashtëzakonshëm juridike.

V. Vështrimet përfundimtare

Ligji i AKP-së dhe Shtojca e tij si dhe LDHP-ja kanë përcaktuar mjete proceduralo-juridike dhe kanë rregulluar procedurën në të cilën kreditori i supozuar i NSH-së në likuidim mund të ndjek kërkesat dhe pretendimet pronësore dhe kreditore ndaj NSH-së. Fillimisht procedura administrative pranë Autoritetit të Likuidimit dhe pastaj procedura gjyqësore pranë DHPGJS-së, janë mjete efektive procedurale për kreditorin e supozuar të NSH-së që nga këto autoritet publike administrative dhe gjyqësore të kërkoj të realizoj të drejtën e pretenduar pronësore apo kreditore të tij.

Pas fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së, procedura administrative pranë Autoritetit të Likuidimit është ajo që duhet të ndiqet fillimisht nga ankuesi dhe pastaj vjen procedura gjyqësore pranë DHPGJS-së.

Nëse ankuesi ka filluar për të njëjtën kërkesë dy procedura paralele njërën pranë gjykatës dhe tjetrën pranë Autoritetit të Likuidimit në parim procedura para gjykatës duhet të pezullohet, ndërsa procedura gjyqësore lidhur me ankesën ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit duhet të vazhdojë.

Në cilën do procedurë paralele nëse është zgjidhur çështja kontestuese me vendim të formës së prerë, ky rezultat ka ndikim të pashmangshëm në rrjedhën e mëtejme dhe përfundimin e procedurës tjetër në pritje.

Pas fillimit të procedurës së likuidimit , parashtruesi i kërkesës gjithmonë duhet ti shterrë mjetet juridike të përcaktuara me ligj pranë AKP-së në mënyrë që më pastaj nëse atje ndahet i pakënaqur duhet ti drejtohet gjykatës.

Nëse ende nuk ka filluar procedura e likuidimit ndaj NSH-së, ndaj së cilës kreditori i supozuar ka kërkesë pronësore dhe kreditore ai nuk duhet të presë ditën e fillimit të procedurës së likuidimit të kësaj NSH-je, por me padi edhe më herët ka mundësi ligjore ti drejtohet gjykatës për ti realizuar të drejtën e pretenduar ndaj NSH-së.